


## **RAPORTI TEKNIK**

### **OBJEKTI: REHABILITIM DHE MASA INXHINIERIKE NYJA E FLLAKES**



## **Permbajtja:**

1	Gjendja ekzistuese	3
2	Pershkrimi projektit	4
2.1	Seksioni tërthor	5

## 1 Gjendja ekzistuese

Projekti ne fjale eshte hartuar duke u bazuar ne kerkesen e banoreve te zones se Shijakut dhe Fllakes, pasi ne nderhyrjet e fundit e bera nga ARRSH ne autostraden Tirane – Durres eshte vendosur guardrail ne te gjithe gjatesine e kesaj zone duke nbullur dhe disa kalime te hapura nga vete banoret per akses ne autostrate. Nisur nga keto kushte bizneset dhe banoret nga te dy anet e autostrades e kane jetike ndertimin e nje kryqezimi per te patur akses ne autostrate.



**Figura 1-1 Pamje e gjendjes ekzistuese**


Ne gjendjen aktuale ne kete zone eshte ndertuar nje mbikalim qe lidh zonen e Fllakes me zoene e Shijakur por pa patur akses ne autostrate.



**Figura 1-2 Pamje e gjendjes ekzistuese**

## 2 Pershkrimi projektit

Projekti kosiston ne ndertimin e kater rampave qe lidhin mbikalimin e Fllakes me zonen Maliq Muco (Krahu djathte i autostrades) dhe zonen e Fllakes (krahu i djathte e austrades). Rampat krijojne mundesine e aksesit per dalje dhe hyrje ne autostrade per te dy zonat si zonen Maliq Muco ashtu dhe ate te Fllakes.



**Figura 2-1 Planimetria e Projektit**

Rampat kane gjatesi te korsise deakselerimti dhe gjatesi te korsise te akselerimit 160m dhe kane rreze 75m. Rampat kane gjeresi 6.25m gjeresi e cila perfshin nje korsi me gjeresi 5m dhe dy bankina me gjerësie 1m dhe 0.75m. Ujrat e shiut jane disiplinuar ne kanal in anesor me gjeresi 2m.

Paketa e shtresave eshte ne dy tipe dhe perbehet:

Tipi pare i aplikuar nga progresivat 0+200.00 – deri ne fund te rampave:

- 4cm asfalt
- 6cm binder
- 10cm konglomerat
- 15cm stabilizant
- Baza 2x25cm cakell
- Mbushje /germim sipas seksionit

Kjo pakete shtresash eshte bere ne menyre qe te kemi unifikimin e shtresave te autostradës me rampat e reja qe do te ndërtohen ne pjesën ku ato bashkohen. Kjo pakete shtresash gjithashtu siguron dhe lëvizjen e trafikut te autodtrades qe mund te kaloje ne rampa. Me tej me degëzimin e rampave dhe uljes se shpejtësisë s elevizjes eshte bere dhe ndryshimi i pakeses se shtresave si me poshtë.

Tipi dyte i aplikuar:

- 4cm asfalt
- 6cm binder
- 15cm stabilizant
- Baza 2x25cm cakell
- Mbushje /germim sipas seksionit

## 2.1 Seksioni tërthor

Seksioni tërthor eshte i realizuar me dy korsi levizeje me gjerësi 2.5m secila. Ne te dy anët e rrugës janë parashikuar bankina me nje gjerësi prej 1m nga ana e djathte dhe 0.75m nga ana e majte e koresive duke u referuar sipas drejtimit te lëvizjes. Gjithashtu eshte bere edhe parashikimi i menaxhimit te ujrave te shirave




Figura 2-2 Seksioni terthor tip 1

PROFILI TIP 2




Figura 3-3 Seksioni terthor tip nr 2

PROFILI TIP 3




Figura 4-4 Seksioni terthor tip nr 3

PROFILI TIP 4




Figura 5-5 Seksioni terthor tip nr 4

PROFILI TIP 5




Figura 6-6 Seksioni terthor tip nr 5

PROFILI TIP 6




Figura 7-7 Seksioni terthor tip nr 6

PROFILI TIP 7






Figura 7-7 Seksioni terthor tip nr 7




Figura 7-7 Seksioni terthor tip nr 8

Ne projekt eshte parashikuar dhe ndertimi i dy rrethrotullimeve ne zonat e bashkimit te rruges ekzistuese Maliq Muco – Fllake me rampat e reja te parashikuara ne projekt. Te dy keta rrethorullime kane diametrin e brendshem 12m dhe gjeresi kaluese 7m, gjithashtu kane te parashikuar dhe ishujt e trafikut.




Figura 2-3 Rrethrotullimi ne Maliq Muco




Figura 2-4 Rrethrotullimi ne zonen e Fllakes

Gjithashtu ne projektin “Rehabilitim dhe masa inxhinierike Nyja e Fllakes” jane parashikuar dhe marrja e masave inxhinierike si ndertimi i mureve betoni pritës ne kra te rampës. Keta mure do te ndërtohen ne ane te rampës ku kemi mbikalimin te cilët do te jene pengese per reshkitjen e dherave ne rruge.




Figura 2-5 Muri Prites betoni ne ane te rampave.